

Trianë 05.04.2021

Drejtuar: Sh.T. Z. Edi Rama,

Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

## LETËR E HAPUR

I nderuar Z. Kryeministër Edi Rama,

Në deklaratën tuaj në 1 prill 2021 në [Top Channel](#)<sup>1</sup> ju deklaruat se Vjosa tashmë është një Zonë e Mbrojtur dhe se një Park Kombëtar nuk është kategoria e duhur e mbrojtjes, sepse do të pengonte aktivitetin agroturistik në zonë. Konkretisht ju thatë: "Vjosa është një Zonë e Mbrojtur por ne nuk mund ta shpallim atë luginë të gjerë si Park Kombëtar sepse kjo do të pengonte zhvillimin e agroturizmit, përkundrazi agroturizmi duhet të jetë pjesë e asaj zone"

Nisur nga ky reagim publik do të dëshironim të saktësonim përmes kësaj letre disa aspekte të rëndësishme që lidhen me të ardhmen e lumit Vjosa.

### Statusi i Mbrojtjes së Vjosës

Duke vlerësuar gatishmërinë e Qeverisë për të shpallur Vjosën, Zonë të Mbrojtur që nga [deklarata Juaj publike](#)<sup>2</sup> në shtator 2020, deri më sot ekziston vetëm një [Vendim](#)<sup>3</sup> i Këshillit Kombëtar të Territorit që parashikon se Vjosa do të shpallet si Park Natyror/Rezervat Natyror i Menaxhuar (Kategoria IV). Sipas ekspertëve ndërkombëtarëve, kjo është një kategori shumë e ulët dhe e papërshtatshme e mbrojtjes. Do të donim të theksonim se aktualisht kemi dy Parqe Natyrore në Shqipëri, nga të cilët njëri është rezervuari i hidrocentralit të Ulzës. Për më tepër në [vendimin](#)<sup>4</sup> e KKT-së, nuk përfshihen degët e Vjosës, të cilat gjithashtu do të ishin jetike për shëndetin e qëndrueshëm të gjithë luginës.

Në Shkurt 2021 ne, EcoAlbania së bashku me 20 OJQ brenda vendit paraqitëm zyrtarisht [kërkesën dhe propozimin](#)<sup>5</sup> tonë për shpalljen e lumit Vjosa dhe degëve të tij si një Park Kombëtar në të gjithë gjatësinë e tij. Paralelisht ne jemi informuar se IUCN, Unioni

<sup>1</sup> Open at Top Channel: <https://youtu.be/kHD2UvaapOE>

<sup>2</sup> <https://twitter.com/ediramaal/status/1309447758483460099>

<sup>3</sup> <http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6099&token=cc165dfe23b6652028a4de33944dee2fca23bd8f>

<sup>4</sup> <http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6098&token=c6c19e064a3ec8bcc0d0736c1d92ddb745655fde>

<sup>5</sup> [https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2021/02/Vjosa-WRNP-proposal\\_ALB.pdf](https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2021/02/Vjosa-WRNP-proposal_ALB.pdf)

Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, gjithashtu ka publikuar një [studim](#)<sup>6</sup> që përcakton mbrojtjen e luginës së Vjosës si Park Kombëtar.

### **Parku Kombëtar dhe ekoturizmi**

Lidhur me shqetësimet Tuaja se lugina e Vjosës nuk mund të jetë Park Kombëtar, sepse do të parandalonte zhvillimin e agroturizmit, me kënaqësi do T'JU ftonim të merrni në konsideratë studimin e IUCN në këtë drejtim. Udhëzimet e IUCN për Parqet Kombëtare përfshijnë edukimin dhe rekreacionin e vizitorëve (ekoturizmin) si një komponent të rëndësishëm të menaxhimit të Parkut Kombëtar. Në fakt, Parku Kombëtar është e vetmja kategori e mbrojtjes që ndërthur mbrojtjen e natyrës, rekreacionin dhe edukimin në mënyrën më të mirë.

Në kundërshtim me deklaratën tuaj, opsioni e Parkut Kombëtar është një tërheqje shtesë për turistët, një markë e veçantë e turizmit. Në rastin e Vjosës, kjo do të ishte edhe më e vërtetë, kur flitet për Parkun Kombëtar të parë të një lumi të Egër të Evropës. Për më tepër tashmë ka shumë shembuj të mirë të Parqeve Kombëtare të ngjashme në rajon si:

- **Siloveni:** Parku Kombëtar Triglav (lumi Soča): mbi 2,5 milion vizitorë në vit me më shumë se 5 milion € të ardhura për bizneset lokale.
- **Kroaci:** Parku Kombëtar Krka: Mbi 1,3 milion vizitorë në vit
- **Maqedonia Veriore:** Parku Kombëtar i Mavrovës pret më shumë se 3% të turistëve në të gjithë vendin çdo vit
- **Austri:** Parku Kombëtar i Danubit, mbi 1,5 milion vizitorë në vit

Prandaj, përcaktimi i Vjosës dhe degëve të saj si Park Kombëtar, do të tërhiqte ekoturizmin dhe do të gjeneronte të ardhura të konsiderueshme për njerëzit dhe bizneset lokale në atë zonë. Për më tepër, ai do t'i siguronte një rajoni të tërë - dhe mbase gjithë vendit - një vizion të ri dhe pozitiv.

**Duke marrë parasysh sa më sipër, ne do të dëshironim të theksonim se regjimi më i përshtatshëm i mbrojtjes për Vjosën nuk do të ishte asgjë tjetër përveç Parkut Kombëtar (Kategoria II) sepse:**

1. Siguron ruajtjen afatgjatë të integritetit natyror, biodiversitetit dhe proceseve natyrore të një ekosistemi kaq të gjerë, të larmishëm dhe të gjallë
2. Përfaqëson opsionin më të mirë për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin rajonal përmes një truzimi të qëndrueshëm bazuar në natyrë, kulturë dhe bujqësi

---

<sup>6</sup> [https://www.iucn.org/sites/dev/files/content/documents/iucn\\_vjosa\\_river\\_valley\\_protection\\_study\\_draft.pdf](https://www.iucn.org/sites/dev/files/content/documents/iucn_vjosa_river_valley_protection_study_draft.pdf)

Me këtë rast do të ishim të lumtur të kishim një takim me ju dhe të diskutonim për opsionet dhe mundësitë sesi ne dhe organizatat ndërkombëtare mund të mbështesim Shqipërinë për krijimin e Parkut të parë Kombëtar të një lumit të egër në Evropë.

Ne do të ishim të lumtur nëse mund të na njoftoni, nëse dhe kur do të ishte e mundur për një takim me JU.

Me besim të fortë në bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Olsi Nika



Drejtori Ekzekutiv

EcoAlbania